

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2015

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore
05.01.2015		16,600.00	3,000.00
08.01.2015		10,180.00	2,000.00
15.01.2015		17,270.00	1,400.00
20.01.2015	3,000.00		
21.01.2015	3,000.00		
22.01.2015		22,230.00	2,710.00
23.01.2015	4,170.00		
29.01.2015		18,820.00	3,000.00
05.02.2015		14,660.00	2,500.00
12.02.2015		11,070.00	1,650.00
19.02.2015		15,480.00	1,720.00
20.02.2015	1,190.00		
23.02.2015	2,770.00		
26.02.2015		16,160.00	3,000.00
05.03.2015		16,440.00	3,000.00
12.03.2015		14,920.00	2,950.00
19.03.2015		18,280.00	2,450.00
23.03.2015	5,460.00		
26.03.2015		20,760.00	3,000.00

tremujorin e parë të vitit, është realizuar vetëm një ankand për shitje me të drejta të plota të bonove të thesarit 6-mujore për shumën 500 milionë lekë. Si rrjedhim, portofoli i BSh-së, në fund të tremujorit të parë të vitit 2015, rezulton të jetë 500 milionë lekë më i ulët se niveli i fillimvitit.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Depozita njëditore është përdorur në 46 raste, mesatarisht për 6.74 miliardë lekë, kundrejt 35 rasteve në tremujorin e kaluar me mesatare përdorimi 5.39 miliardë lekë.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 10 raste, përqendruar në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës, për mesatarisht 2.61 mld lekë. Në tremujorin e kaluar, instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 2 raste përkatësisht për 1.95 mld lekë dhe 2.39 mld lekë.

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2015, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit dhe operacione të përhershme, me qëllim strukturimin e portofolit të BSH-së.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 21.30 miliardë lekë, kundrejt nivelit 28.21 miliardë lekë të regjistruar në tremujorin e fundit të vitit 2014. Likuiditeti mesatar i injektuar rezulton pranë nivelit të tremujorit të parë të vitit 2014, kur kjo vlerë ishte rreth 21.22 mld lekë.


Për injektimin e likuiditetit të përkohshëm në tremujorin e parë të vitit, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjellë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 16.37 miliardë lekë në javë*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjellë riblerjeje me maturim njëmujor, mesatarisht 2.49 miliardë lekë në javë*.

Operacionet injektuese njëditore janë përdorur në gjashtë raste, përqendruar në fund të periudhës së mbajtjes së rezervës.

Në fund të tremujorit të parë të vitit është rifilluar me operacionet për shitblerje me të drejta të plota, duke synuar uljen e zotërimit të BSh-së në bono thesari. Në

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2015.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2011-2015 (me çmim blerjeje)




2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2015

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në tremujorin e parë të vitit 2015, Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor.

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e parë të vitit 2015



2.2 Veprime me institucione të tjera

Në tremujorin e parë të vitit, kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë, kundrejt lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit, që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj. Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, kontratat *swap* qenë mesatarisht 131.7 milionë euro në ditë ose rreth 18.4 mld lekë, kundrejt 27.7 milionë eurove në ditë gjatë tremujorit të kaluar ose rreth 4 mld lekë. Në mbyllje të tremujorit, marrëveshjet e pamaturuara *swap* qenë 70 milionë euro dhe 46 milionë SDR, kundrejt 120 milionë eurove në fund të tremujorit të kaluar. Si rezultat i marrëveshjeve *swap* të lartpërmendura, blerjet e valutës së BSh-së nga MF-ja qenë 97,423.35 milionë lekë dhe shitjet 97,548.14 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 51.68 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	97,423.35	97,548.14
TË TJERA (IDA, IBRD)	51.68	